

Në pajtim me nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13 dhe 1.17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.77 / 16, gusht 2010), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150, nenin 8, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.12/03, maj 2013), Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29 dhjetor 2023 miratoi këtë:

UDHËZIM PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË PAGESAVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktoj funksionimin dhe organizimin e Këshillit Kombëtar të Pagesave (në vijim: *KKP*), si një organ këshillues dhe mbështetës në rritjen e sigurisë së Sistemit Kombëtar të Pagesave të Republikës së Kosovës (në vijim: Sistemi Kombëtar i Pagesave), përbërjen, kompetencat dhe detyrat e tij.
2. Objektivi i *KKP*-së është të këshilloj BQK-në dhe anëtarët e tij lidhur me rregullimin, mbikëqyrjen dhe zhvillimin e Sistemit Kombëtar të Pagesave dhe nëpërmjet veprimeve të tij, të mbështes dhe të kontribuoj në vendosjen e parimeve dhe standardeve operacionale dhe teknike, si dhe rregullave tjera të nevojshme për promovimin e një sistemi të pagesave të sigurt dhe efikas dhe në avancimin e mëtejshëm të shërbimeve të pagesave në Kosovë.
3. *KKP* shërben si një forum i bashkëpunimit dhe do të kontribuojë për zhvillimet e sistemit të pagesave dhe infrastrukturës së shërbimeve financiare të Kosovës, si dhe në zhvillimet e ndërlidhjeve me sistemet e pagesave rajonale dhe ndërkombëtare.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjithë termat në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në Ligjin nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave dhe/ose me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e këtij Udhëzimi.
 - 1.1. “**BQK**” – nënkupton Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;

1.2. "Sistemi Kombëtar i Pagesave" nënkupton çdo sistem të pagesave, transfereve, sistem të shlyerjes së letrave me vlerë, sistem të kliringut dhe çdo aranzhim të shfrytëzuar gjatë procesit të kryerjes së transaksioneve të pagesave, sikurse është përcaktuar me neni 2, paragrafi 1.13 të Ligjit Nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave. Elementet kryesore të Sistemit Kombëtar të Pagesave përfshijnë:

- 1.2.1. Instrumentet e Pagesave që përdoren për inicimin dhe drejtimin e transfereve të fondeve ndërmjet llogarive të paguesve dhe të paguarve në institucionet financiare;
- 1.2.2. Infrastrukturat e Pagesave për transferimin dhe kliringun e instrumenteve të pagesave, për procesimin dhe komunikimin e informatave të pagesave, si dhe për transferimin e fondeve ndërmjet institucioneve urdhëruese dhe pranuese;
- 1.2.3. Institucionet financiare të cilat sigurojnë llogari të pagesave, si dhe instrumente dhe shërbime të pagesave për konsumatorët dhe bizneset, si dhe organizatat të cilat operojnë me shërbimet e rrjeteve të transaksioneve të pagesave, kliringut dhe shlyerjes së tyre për institucionet financiare;
- 1.2.4. Korniza rregullative e tregut, që përfshinë marrëveshjet, konventat, rregulloret dhe kontratat për lëshimin dhe pranimin e instrumenteve dhe shërbimeve të ndryshme të pagesave, si dhe çaktimin e çmimit të tyre;
- 1.2.5. Korniza ligjore dhe rregullative, përmes të cilave përkufizohen dhe udhëhiqen mekanizmat e proceseve të transfereve të pagesave dhe mënyrën e ofrimit të shërbimit të pagesave për tregun;
- 1.2.6. Infrastruktura e pagesave përfshinë të gjitha infrastrukturat specifike individuale që operojnë në Kosovë, edhe ato me seli qendrore jashtë vendit;
- 1.2.7. Marrëveshjet institucionale, të cilat përfshijnë marrëveshjet e akterëve të tregut për shërbime të ndryshme të pagesave dhe ndërmjet ofruesve të ndryshëm të shërbimeve të pagesave për përdoruesit, si bankat dhe/apo IFJB-të;
- 1.2.8. Pjesëmarrësit tjerë dhe organizimet tjera institucionale të Sistemit Kombëtar të Pagesave, si BQK, Thesari dhe KKP.

Neni 3 Kompetencat

1. KKP në rolin e tij këshillues, ka këto kompetenca:
 - 1.1. Të këshilloj BQK-në dhe anëtarët e tij në çdo çështje që ndërlidhet me Sistemin Kombëtar të Pagesave;
 - 1.2. Të inkurajoj dhe lehtësoj bashkëpunimin ndërmjet pjesëmarrësve të Sistemit Kombëtar të Pagesave, pjesëmarrësve të tregut dhe rregullatorëve të tregut të pagesave dhe ndërmjet të gjithë pjesëmarrësve aktivë në ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe operimin e infrastrukturës së pagesave brenda Kosovës dhe në nivel ndërkombëtar;
 - 1.3. Të ndihmoj BQK-në dhe anëtarët e tij në *zbatimin*, rregullimin, mbikëqyrjen dhe zhvillimin e Sistemit Kombëtar të Pagesave.

- 1.4. Opinionet dhe veprimet e KKP-së në kuadër të funksionit të tij këshillues dhe konsultativ, nuk duhet të zbehin, zvogëlojnë apo kufizojnë fuqitë dhe kompetencat e BQK-së të përcaktuara me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi.

Neni 4 **Detyrat**

1. KKP ka detyrat si në vijim:

- 1.1. Promovoj iniciativa të përbashkëta apo individuale për mbështetjen e ngritjes së vetëdijes publike mbi Sistemin Kombëtar të Pagesave dhe të promovoj njohuritë lidhur me shërbimet e pagesave dhe çështjet e sistemit të pagesave në Kosovës. Për këtë qëllim KKP mund të përdor çdo mënyrë që vlerësohet e përshtatshme, përfshirë por duke mos u kufizuar në: tryezat, seminarët, ueb faqet, reklamimet, gazetatat etj;
- 1.2. Të shpërndaj informacionin dhe përvojat relevante ndërmjet anëtarëve të tij;
- 1.3. Promovoj standardizimin e procedurave, teknologjive, shërbimeve dhe sistemeve për anëtarët e tij;
- 1.4. Monitoroj zbatimin e projekteve të Sistemit Kombëtar të Pagesave dhe iniciativave të ndryshme relevante në Kosovë;
- 1.5. Promovoj iniciativat e përbashkëta drejtë zbatimit të infrastrukturës së sistemit të pagesave. Këto iniciativa duhet të nxisin dhe fuqizojnë konkurrencën e shëndosh ndërmjet pjesëmarrësve;
- 1.6. Përgatit dokumentet strategjike për arkitekturën e përgjithshme të vendit për sistemin e pagesave;
- 1.7. Monitoroj zbatimin e reformave në sektorin e pagesave;
- 1.8. Lehtësoj shkëmbimin e informatave të nevojshme ekonomike dhe biznesore për të gjitha palët e ndikuara nga shërbimet dhe infrastrukturën e pagesave;
- 1.9. Vlerësoj ndikimin e opsioneve të ndryshme për biznesin dhe operacionet ditore të pjesëmarrësve të ndryshëm të sistemit dhe interesat e përdoruesve final;
- 1.10. Këshilloj lidhur me përzgjedhjen e parimeve dhe opsioneve kryesore në dizajnimin e sistemeve dhe infrastrukturave të caktuara;
- 1.11. Përcaktoj prioritetet dhe afatet e inicimit/financimit/implementimit të projekteve të veçanta;
- 1.12. Identifikoj nevojat për instrumentet ligjore lidhur me Sistemin Kombëtar të Pagesave dhe rekomandoj te anëtarët e tij adresimin e tyre;
- 1.13. Themeloj grupe punuese për vlerësime teknike të nevojshme për mbështetjen veprimeve të KKP-së dhe për nxjerrjen e opinioneve/deklaratave të përbashkëta, si dhe për përgatitjen e dokumenteve strategjike;
- 1.14. Analizoj dhe diskutoj zhvillimet dhe inovacionet e reja në fushën e sistemeve dhe shërbimeve të pagesave dhe mundësitë të adaptimit të tyre, si dhe ndikimit që mund të kenë;
- 1.15. Informoj dhe diskutoj me të gjithë anëtarët lidhur me procesin e harmonizimit të legjislacionit të pagesave në Kosovë me Direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian; dhe

1.16. Çdo detyrë tjetër e cila i shërben qëllimit ligjor të themelimit të tij dhe e cila vendoset ndërmjet anëtarëve, si çështje me rëndësi për objektivat e KKP-së.

Neni 5 **Përbërja e KKP-së**

1. Anëtarët e përhershëm të KKP-së me të drejtë vote, janë:
 - 1.1. BQK me përfaqësuesit në vijim:
 - 1.1.1. Zëvendësguvernatori për Operacionet Bankare, në rolin e Kryesuesit të KKP;
 - 1.1.2. Drejtori i Departamentit të Sistemit të Pagesave, në rolin e Zëvendës Kryesuesit;
 - 1.1.3. Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare në BQK;
 - 1.1.4. Udhëheqësi i Divizionit të Mbikëqyrjes së Sistemeve të IT-së në BQK;
 - 1.1.5. Përfaqësuesi i Kabinetit të Guvernatorit;
 - 1.2. Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
 - 1.3. Shoqata e Bankave të Kosovës (në vijim: SHBK) me përfaqësuesit në vijim
 - 1.3.1. Kryetari i Bordit të SHBK;
 - 1.3.2. Drejtori Ekzekutiv i SHBK; dhe
 - 1.3.3. Kryesuesi i Komitetit të Pagesave në SHBK.
 - 1.4. Dy përfaqësues nga Institucionet Financiare Jo-bankare (në vijim: IFJB-të) të cilat kryejnë veprimtarinë e shërbimeve të pagesave dhe transfereve dhe / ose emetimin e parave elektronike, përkatësisht nga shoqata përkatëse; dhe
 - 1.5. Një përfaqësues nga operatorët privat të sistemeve të pagesave.
2. Secili nga anëtarët e përcaktuar me paragrafin 1 të këtij neni kanë të drejtën e një vote.
3. Anëtarët e KKP-së sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të vendosin kushtet dhe procedurat për zëvendësimin e përfaqësuesve të tyre në rast të mungesës apo pamundësisë së pjesëmarrjes së përfaqësuesve të caktuar.
4. Përfaqësuesit e IFJB-ve referuar në nën-paragrafin 1.4 të këtij neni duhet të caktohen nga IFJB-të relevante sipas rregullave që ato përcaktojnë, të cilat duhet ta njoftojnë KKP-në për personat e caktuar për përfaqësim.
5. KKP mund të vendos caktimin e anëtarëve shtesë, me apo pa të drejtë vote, për të ju mundësuar përfaqësimin institucioneve tjera që kanë ndërlidhje me Sistemin Kombëtar të Pagesave, varësisht nga nevojat dhe zhvillimet e tregut, të cilat mund të përfshijnë:
 - 5.1. Agjencitë Qeveritare dhe Publike;
 - 5.2. Institucione financiare dhe jo-financiare;
 - 5.3. Shoqata të përdoruesve final, si konsumatorëve apo tregtarëve;
 - 5.4. Shoqata komerciale apo industriale; dhe

- 5.5. Pjesëmarrës nga industria e telekomunikacionit dhe kompanive të shërbimeve publike.
6. Anëtarët e KKP-së duhet të:
- 6.1. Shmangen nga çdo përpjekje për influencimin e BQK-së apo anëtarëve tjerë me qëllim të përfitimeve individuale;
 - 6.2. Ruajnë konfidencialitetin e të gjitha informatave të siguruar në relacion me palë tjera;
 - 6.3. Të ofrojnë përpjekjet më të mira të tyre dhe të ofrojnë kujdesin e duhur në vlerësimin dhe verifikimin e të gjithë informacionit të shpërndarë apo shpalosur ndërmjet anëtarëve;
 - 6.4. Përfaqësohen nga anëtarët e tyre sipas përcaktimeve të këtij neni, përveç rasteve ku marrin pjesë me përfaqësuesit e tyre në grupet punuese të caktuara sipas paragrafit 1 të nenit 6, në të cilat mund të përfaqësohen në nivel teknik.
7. Anëtarët tjerë pa të drejtë vote janë nga Sekretaria e KKP-së, e cila përbëhet nga:
- 7.1. Një zyrtar nga Departamenti i Sistemit të Pagesave në BQK; dhe
 - 7.2. Një zyrtar i Shoqatës së Bankave të Kosovës.
8. Sekretaria, varësisht nga vendimi i KKP-së bazuar në paragrafin 5 të këtij neni, do të kontaktoj me kohë institucionet relevante lidhur me pjesëmarrjen e tyre dhe ofrimin e informacionit të nevojshëm sa i përket rolit të tyre si pjesëmarrës me apo pa të drejtë vote.

Neni 6 Metodologjia

1. KKP mund të themeloj grupe punuese për adresimin e çështjeve apo zhvillimeve specifike. Grupet punuese mund të themelohen nga pjesëmarrja e të gjithë anëtarëve apo vetëm e anëtarëve relevant me çështjet specifike.
2. KKP mund të përgatis raporte periodike mbi sistemet e pagesave dhe çështjet e pagesave, të cilat nuk duhet të jenë të natyrës përshkuese, por të shërbejnë si referencë për zhvillimet e vazhdueshme të Sistemit Kombëtar të Pagesave në Kosovë.
3. KKP do të raportoj në baza vjetore, para datës 31 mars të vitit vijues, lidhur me aktivitetet e ndërmarrja gjatë vitit kalendarik paraprak. Raportet do të dërgohen tek menaxhmenti i lartë i secilit prej institucioneve pjesëmarrëse si anëtar të përhershëm.

Neni 7 Mbledhjet e Këshillit

1. KKP duhet të organizoj mbledhje në minimum një (1) herë në vit, me ftesën e Kryesuesit duke marrë në konsideratë prezencën e anëtarëve tjerë.
2. Secili anëtar apo grup i anëtarëve mund të propozoj nga Kryesuesi organizimin e mbledhjes lidhur me çështje specifike, relevante.
3. Kryesuesi organizon mbledhjet nëse i kërkohet nga minimum (2/3) dy-të-tretat e anëtarëve, me të drejtë vote.

4. Datat, shpeshësia dhe lokacioni i mbledhjeve do të përcaktohet nga Kryesuesi në konsultim me anëtarët.
5. Takimi drejtohet nga Kryesuesi apo Zëvendës Kryesuesi dhe në rast të mungesës së tyre, anëtarët do të vendosin për personin që do të drejtojë mbledhjen para fillimit të takimit.
6. KKP mund të mbledhet me prezencën e minimum pesëdhjetë (50%) përqind e anëtarëve me të drejtë vote (kuorumi).
7. KKP mund të ftoj, në rastet që konsiderohet e përshtatshme bazuar në agjendën dhe çështjet e parapara për diskutim, institucione tjera kombëtare apo ndërkombëtare dhe/apo ekspert individual, për pjesëmarrje në mbledhje.
8. Anëtarët e KKP-së, ose kur është e aplikueshme, pjesëmarrësit e çdo mbledhje të KKP-së, do të përcjellin rezultatet, konkluzionet dhe çdo informacion të siguar në atë mbledhje, tek institucionet relevante që i përfaqësojnë.

Neni 8 Shpenzimet

1. Anëtarët nuk kompensohen nga KKP, dhe secili institucion i përfaqësuar me anëtarë në KKP i bart shpenzimet e anëtarëve të tij.
2. Kostoja për secilën mbledhje, si p.sh. qiraja e hapësirës ku mbahet mbledhja, shpenzimet e qirasë apo blerjes së inventarit apo pajisjeve të nevojshme, si dhe shërbimeve tjera, do të financohen nga institucion i përfaqësuar me anëtarë në KKP që merr përsipër organizimin e mbledhjes.
3. Anëtarët mbështesin me shpërndarjen e kostos së shpenzimeve për çdo aktivitet të ndërmarrë nga KKP- ja në mënyrë të barabartë dhe pas aprovimit të mbledhjes së mbajtur sipas Nenit 7 të këtij Udhëzimi.

Neni 9 Detyrat e Kryesuesit dhe Sekretarisë

1. Kryesuesi i KKP-së do të ketë detyrat në vijim:
 - 1.1. Thërret dhe drejton mbledhjet;
 - 1.2. Cakton datën dhe vendin e mbledhjes;
 - 1.3. Aprovon agjendën e përgatitur nga Sekretaria varësisht nga propozimet e anëtarëve të KKP-së;
 - 1.4. Aprovon pjesëmarrjen e institucioneve tjera apo ekspertëve individual, në pajtim me nenin 5, paragrafi 5, të këtij udhëzimi;
 - 1.5. Nënshkruan vendimet e KKP-së; dhe
 - 1.6. Drejton aktivitetet e përgjithshme të KKP-së bazuar në kompetencat dhe detyrat e caktuara me këtë udhëzim.
2. Sekretaria e KKP-së do të ketë detyrat si vijon:



- 2.1. Mbledhë propozimet dhe përgatit agjendën e mbledhjeve, të cilën e dërgon te Kryesuesi për aprovim;
- 2.2. Përgatit letrat dhe dokumentet e nevojshme për organizimin e mbledhjeve;
- 2.3. Siguron agjendën e mbledhjeve për secilin anëtar/institucion pjesëmarrës, së bashku me materialin e nevojshëm, së paku dhjetë (10) ditë kalendarike para mbajtjes së mbledhjes;
- 2.4. Regjistron procesverbalin e mbledhjes, i cili aprovohet nga KKP, pas takimit. Procesverbali duhet të përfshijë së paku:
 - 2.4.1. Datën dhe kohën e mbledhjes;
 - 2.4.2. Emrat e të gjithë pjesëmarrësve (kryesuesit, anëtarëve dhe të ftuarve);
 - 2.4.3. Temat e ngritura dhe të diskutuara dhe në rast se kërkohet, konfidencialitetin e çështjes të përcaktuar nga KKP;
 - 2.4.4. Llojin dhe burimin e materialit të shqyrtuar dhe përdorur;
 - 2.4.5. Personat e përfshirë në diskutim dhe objektin e atyre diskutimeve;
 - 2.4.6. Propozimet të cilat kalojnë për votim;
 - 2.4.7. Kryerjen e votimit dhe rezultatet e tij, përfshirë votat pro dhe kundër me argumentimet përkatëse;
 - 2.4.8. Konkluzionet e mbledhjes.
- 2.5. Përgatit vendimet dhe konkluzionet, të cilat përfshijnë propozimet / rekomandimet / sugjerimet e vendosura nga KKP, së paku në dy (2) kopje. Një kopje ruhet nga Sekretaria dhe kopja tjetër i dërgohet Kryesuesit dhe te institucionet tjera relevante që janë përgjegjëse për çështjet e përfshira;
- 2.6. Mirëmban dhe përditëson materialet për publikim në ueb faqen zyrtare të BQK-së;
- 2.7. Përgatit përmbledhjen e informacionit mbi aktivitetet e KKP-së dhe e shpërndan atë te pjesëmarrësit tjerë për miratim; dhe
- 2.8. Çdo detyrë tjetër që i shërben punës së KKP-së dhe e cila i caktohet nga Kryesuesi.

Neni 10

Vendimmarrja

1. KKP-ja ka për qëllim marrjen e vendimeve për të cilat janë dakord të gjithë anëtarët. Megjithatë, në rastet kur kjo nuk është e mundur, vendimet merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të përfaqësuar në mbledhje.
2. Vota e Kryesuesit të mbledhjes është përcaktuese në rastet kur rezulton votim i barabartë i anëtarëve të përfaqësuar, pro dhe kundër një vendimi. Votat kundër paraqiten në detaje dhe të argumentuara në procesverbalin e takimit.
3. Vendimet e KKP-së nënshkruhen nga Kryesuesi dhe përfaqësuesit e anëtarëve me të drejtë vote, si dhe nga Sekretaria, në dy (2) kopje. Një kopje ruhet në Sekretari dhe kopja tjetër i dërgohet Kryesuesit dhe institucioneve tjera relevante, varësisht nga lënda e vendimit.

4. Vendimet e KPK nuk janë detyruese për BQK-në apo ndonjë nga institucionet pjesëmarrëse, por ato kanë karakter këshillues bazuar në rolin dhe qëllimin e themelimit të tij.

Neni 11

Shpalosjet

1. Rezultatet, opinionet, raportet apo çdo informacion tjetër i krijuar në mbledhjet e KKP-së do të shpaloset për të gjitha palët e interesuara sipas kushteve për të cilat pajtohen anëtarët, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Informacioni konfidencial dhe senzitiv lidhur me një nga anëtarët, i siguruar nga anëtarët tjerë apo nga ndonjë person apo entitet, gjatë mbledhjeve, punëve përgatitore, bisedave dhe diskutimeve joformale apo në çfarëdo aktiviteti tjetër të ndërlidhur me KKP-në, nuk duhet të jetë subjekt i shpalosjeve.
3. KKP duhet të zbatoj marrëveshjet e nevojshme të konfidencialitetit dhe/apo mos-shpalosjes të përcaktuara me këtë nen.
4. KKP-ja përgatit dhe publikon në ueb faqen e BQK-së një përmbledhje të veprimeve dhe mbledhjeve të tij.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi me 1 janar 2024.



Ahmet Ismaili
Kryesues i Bordit Ekzekutiv